



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E SHQYRTIMIT DHE MONITORIMIT TË LEJEVE MJEDISORE DHE VNM

AN240420260110

Tiranë, më:20.05.2026

Komisioni 54

Lënda: Kërkohet plotësim informacioni për zhvilluesin “Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durrës” sh.a

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, mori në shqyrtim aplikimin e zhvilluesit “Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durrës Sh.A” me AN240420260110 në lidhje me procedurën paraprake të VNM-së për projektin “Rikonstruksion i Rrjetit të Ujësjiellës të Fshatrave Gorre, Patok, Adriatik, Dukagjin i Ri, Bushnesh, Sukth Vendas dhe Gramez të Njesive Administrative Fushe Kuqe dhe Thumane, Bashkitë Kurbin dhe Krujë.

Në mbështetje të:

- Ligjit nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”;
- VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar;
- Urdhërit të Kryeministrit Nr. 153 Prot, datë: 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data: 01.01.2020”;
- Mendimet e institucioneve të konsultuara.

Pas rishqyrtimit të aplikimit shprehemi si më poshtë:

Në Raportin Teknik mungojnë të dhënat teknike dhe kordinatat GAUS-KRUGE, megjithëse përmenden në raport, mungon lista e plotë e thyerjeve të gjurmës me koordinata X, Y për të gjithë linjën e dërgimit dhe shpërndarjes.

Të ngarkohet në sistem Raporti Teknik i ripunuar me të gjithë informacionin e kërkuar.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet përsëri: Bazuar në dokumentacionin e aplikimit (planvendosjet e paraqitura në dokumentacion), lidhur me zhvillimin e aktivitetit: “Rikonstruksion i rrjetit të ujësjiellës të njësive administrative Fushë - Kuqe dhe Thumanë”, me zhvillues “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a” dhe aplikues “INVICTUS”, me nr. Aplikimi AN240420260110, rezulton se:

Tubi ekzistues dhe depo nuk ndodhen brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

Një pjesë e linjës kryesore të ujësjiellës prek në zonën e mbrojtur RNM “Kune - Vain - Patok - Fushë Kuqe - Ishëm”, shpallur me VKM nr. 60, datë 26.01.2022 “Për shpalljen e Ekosistemeve Natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror (Kategoria IV), si dhe Miratimin e Ndryshimit të Statusit e të

Sipërfaqeve ekzistuese të Zonave të Mbrojtura Mjedisore”, në nënzonën e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm (ZPT/Q) dhe pjesa tjetër nuk bën pjesë në rrjetin e zonave të mbrojtura.

Një pjesë e sipërfaqes së shpërndarjes së linjave të ujit ndodhet në zonën e mbrojtur RNM “Kune - Vain - Patok - Fushë Kuqe - Ishëm”, shpallur me VKM nr. 60, datë 26.01.2022, në nënzonën qëndore (ZQ) dhe në nënzonën e përdorimit tradicional dhe të qëndrueshëm (ZPT/Q), ndërsa pjesa tjetër nuk bën pjesë në rrjetin e zonave të mbrojtura.

Duke u bazuar në Ligjin nr. 81/2017 ‘Për zonat e mbrojtura’, i ndryshuar me Ligjin nr. 21/2024, konkretisht në nenin 10, pika 5, nenin 19, nenin 26, pika 5, nenin 33, nenin 48, nenin 49 si dhe në VKM-në nr. 60, Aneksi nr. 16, vlerësohet se zhvillimi i propozuar duhet të jetë në përputhje me kufizimet dhe kriteret e përcaktuara për zonën përkatëse të mbrojtur.

Ky aplikim do të merret në rishqyrtim pas plotësimi të pikave të mësipërme duke respektuar afatet ligjore, në sistemin e-leje.

Duke Ju falënderuar,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Marjeta Përlala

